



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2020:041550

Datë: 25.05.2023

Numri i dokumentit: 04321673

**PKR.nr.147/21**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË – Departamenti për Krime të Rënda**, Kryetari i trupit gjykues Sami Sharaxhiu si dhe anëtarët e trupit gjykues, gjyqtarët profesionist Shaqë Curri dhe Musë Pavataj , me pjesëmarrjen e sekretares juridike Lulavere Mala, në çështjen penale, ndaj të pandehurit V.T.nga P. dhe të të pandehurit Sh.G. nga I., dhe atë, për të pandehurin V.T., për shkak të veprës penale, Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar , nga neni 414 par.1. të KPRK,dhe vepër penale, marrja e ryshfetit , nga neni 421 par.1. të KPRK-së, ndërsa për të pandehurin Sh.G., për vepër penale, dhënia e ryshfetit , nga neni 422 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së PTHDKR në Pejë PP/I.nr. 23/20 e datës 07.09.2021, në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me datën 05.05.2023, në prani të prokurorit të shtetit Ersan Qavolli, të pandehurit V.T. dhe mbrojtësit të tij av. Kujtim Kerveshi nga Prishtina, i angazhuar sipas autorizimit, të pandehurit Sh.G. si dhe mbrojtëses së tij, av. Shqipdonë Maraj Ferizaj nga Istogu,e angazhuar sipas autorizimit, e në mungesë të përfaqësuesit të Doganave të Kosovës në Prishtinë, me datë 11.05.2023 muarr ,ndërsa me datë 25.05.2023 përpiloi këtë :

**A K T G J Y K I M**

**Të pandehurit**

**V.T.**i lindur me dt....., në P. ku edhe jeton, rr. Xh. B. nr..., i biri Xh. dhe R. e gjinisë K., i martuar- baba i ... fëmijëve, ka të kryer fakultetin Ekonomike, i gjendjes së mesme ekonomike, me profesion Z. D., posedon tel nr. ... - ...-... , i njohur sipas nr. personal ....., Shqiptar , shtetas i Republikës së Kosovës, gjendet në liri .

**SH.G.** i lindur me datë ..... në I., ku edhe jeton rr. B. G. nr. ..., i biri i I. dhe K. e gjinisë A. , i martuar – baba i ... fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme , i gjendje së mesme ekonomike, me profesion punëtor fizik, i njohur sipas nr. Personal ....., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës , gjendet në liri.

**PJESA LIRUESE**

**I pandehuri V.T.**

**Konform nenit 363 par.1. pika 1.3, të KPPRK-së,**

## **LIROHET NGA AKTAKUZA**

### **Gjëja se :**

I.Me datë 08.03.2020, rrethe orës 10:20, në pikën kufitare në K. ( në hyrje ) K. P., në cilësinë e personit zyrtar, nuk i përmbushë detyrat e tij zyrtare me qëllim që personit tjetër të përfitoi dobi pasurore, në atë mënyrë që , në kohën dhe vendin e lartcekur , sh kon i pandehurin Sh. G., i cili po e drejtonte automjetin “M.” me targa ....., dhe rimorkion me targa,....., ku edhe kishte të ngarkuara gjësende të ndryshme ( motor shara , kositës bari, biçikleta etj ), ashtu që i pandehuri V. në cilësinë e zyrtarit doganor, nuk ndërmerr veprimet e duhura që malli në fjalë t’i nënshtrohet procedurave të kontrollit doganor, për çka drejtuesi i automjetit përfiton duke mos paguar tatimet reale për atë sasi malli dhe si rrjedhojë dëmtohet edhe buxheti i shtetit në vlerë prej 225 .00 €.

- me çka kishte për të kryer veprën penale “keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar “, nga neni 414 par.1. të KPRK-së.

Konform nenit 453 par.1 të KPPRK-së , shpenzimet e procedurës penale iu ngarkohen mjeteve buxhetore të gjykatës.

## **PJESA DËNUESE**

### **I pandehuri V.T.**

### **ËSHTË FAJTOR**

### **Për shkak se :**

II.me dt. 08.03.2020, rreth orës 10:20, në zyrën e personelit doganor në pikën kufitare në K. (në hyrje ) K. P., në cilësinë e personit zyrtar, në mënyrë të drejtpërdrejtë pranon përfitim pasuror për vete ,me qëllim që të mos veprojë në pajtim me detyrën e tij zyrtare , në atë mënyrë që ,në kohën dhe vendin e lartcekur , shkon i pandehuri Sh. G. ,i cili po e drejtonte automjetin “M.” me targa ..... dhe rimorkion me targa ....., ku edhe kishte të ngarkuar gjësendet të ndryshme ( motor shara , kositëse bari, biçikleta etj), ashtu që i pandehuri, në cilësinë e zyrtarit doganor, në zyrën e tij, kërkon e pastaj merr nga drejtuesi i automjetit një bankënotë prej 50 €, me nr. serik ....., me qëllim që malli që posedonte ky i fundit të mos i nënshtrohej procedurave të kontrollit doganor.

- me çka ka kryer veprën penale, “marrja e ryshfetit “, nga neni 421 par.1. të KPRK-së.

Andaj, gjykata konform nenit 2, 4 par.1. nën par.1.1 dhe 1.3, nenit 7 , 8 , 9, 10, 38, 39 par.1.nënp. 1.1 dhe 1.3, nenit 40 par.1. nën par.1.2 dhe 1.3, nenit 42, 43,nenit 59 par.1 dhe 2. nën par. 2.3, si dhe nenit 421par.1. të KPRK-së, të pandehurin V.T.e gjykon me :

**Dënim me burg** ashtu që ia shqipton dënimin me burg në kohëzgjatje prej 1 ( një viti ) , e të cilin dënim me burg i pandehuri do ta vuaj pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, si dhe :

**Dënim me gjobë** në shumë prej **1000 € ( një mijë euro )** , e të cilin dënim me gjobë i pandehuri është i obliguar që ta paguaj në afat prej **3 ( tre ) muajve** nga plotfuqishmëria e aktgjykimit , e

po që se i pandehuri nuk e paguan dënimin me gjobë në afatin e caktuar, dënimi me gjobë i zëvendësohet me dënim me burg e ku një ditë burgu i llogaritet në shumë prej 20 € ( njëzet euro).

**Konform nenit 59 par.1. dhe 2 nën par. 2.3, të KPRK-së**, të pandehurit V.T.i shqiptohet dënimi plotësues, ndalimi i ushtrimit të profesionit në administratën publike ose në shërbim publik, në kohëzgjatje prej 1 (një viti ) nga vuajtja e dënimit me burg.

Një kartëmonedhë në shumë prej 1 x 50 €, me nr . serik ....., një kartëmonedhë në shumë prej 1x 10 euro me numër serik ..... si dhe një kartëmonedhë në shumë prej 1 x10 € me numër serik ....., **Konfiskohen** dhe të njëjtat pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit urdhërohet që të alokohen në mjetet buxhetore të Republikës së Kosovës.

Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës penale, gjykatës të ia paguaj shumën prej **50 ( pesëdhjetë euro )**, në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor shumën prej **50 ( pesëdhjetë euro )** si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej **50 € ( pesëdhjetë euro )** e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e aktgjykimit .

**I pandehuri Sh.G.**

**ËSHTË FAJTOR**

**Për shkak se :**

Me dt. 08.03.2020, rreth orës 10:20, në zyrën e personelit doganor në pikën kufitare në K. ( në hyrje), K. P., në mënyrë të drejtë për drejtë i jep përfitim pasuror personit zyrtar, me qëllim që ky i fundit të mos veprojë në pajtim me detyrën e tij zyrtare , në atë mënyrë që, me të arritur në vendin e lartcekur, me automjetin “M.” me targa ....., dhe rimorkion me targa ....., të cilin po e drejtonte , e në të cilin kishte të ngarkuara gjësende të ndryshme , i njëjti me qëllim të mosnënshtrimit të procedurave të kontrollit doganor, i ofron zyrtarit doganor V.T., një bankënotë prej 50 €, me nr. serik ..... , të cilin me kërkesën e tij e vendos në pasaportë të vajza e tij V. e cila gjendej në automjet , e më pas ia jep atë të pandehurit V. në zyrën e tij.

- me çka ka kryer vepër penale “ dhënia e ryshfetit “ nga neni 422 par.1.të KPRK-së,

Andaj, gjykata konform nenit 2, 4 par1. nën par.1.1 dhe 1.2, nenit 7 , 8 , 9, 10, 38, 39 par.1.nëpar 1.1 dhe 1.2, nenit 40 par.1. nën par.1.3, nenit 43, si dhe nenit 422par.1. të KPRK-së të pandehurin Sh.G. e gjykon me :

**Dënim me Kusht** ashtu që ia shqipton dënimin me burg në kohëzgjatje prej 1 ( një viti ) , e të cilin dënim me burg i pandehuri nuk do ta vuaj nëse në afat prej 1 (një ) viti nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale, si dhe :

**Dënim me gjobë** në shumë prej **500 € ( pesëqind euro)**, e të cilin dënim me gjobë i pandehuri është i obliguar që ta paguaj në afat prej **3 ( tre ) muajve** nga plotfuqishmëria e aktgjykimit , e po që se i pandehuri nuk e paguan dënimin me gjobë në afatin e caktuar, dënimi me gjobë i zëvendësohet me dënim me burg e ku një ditë burgu i llogaritet në shumë prej 20 € ( njëzet euro).

Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës penale, gjykatës të ia paguaj shumën prej **50 ( pesëdhjetë euro )**, në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor, shumën prej

**50 ( pesëdhjetë euro )** si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit, shumë prej **50 € ( pesëdhjetë euro )** e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e aktgjykimit .

Për realizimin e kërkesës pasuroro juridike , pala e dëmtuar udhëzohet në kontest të rregullt juridiko civil.

## **A s r y e t i m**

PTHDKR në Pejë, ndaj të pandehurit V.T.nga P. dhe të të pandehurit Sh.G. nga I.,ka ngritur aktakuzë, dhe atë, për të pandehurin V.T., për shkak të veprës penale, Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar , nga neni 414 par.1. të KPRK –së dhe vepër penale, marrja e ryshfetit, nga neni 421 par.1. të KPRK-së, ndërsa për të pandehurin Sh.G., për vepër penale, dhënia e ryshfetit , nga neni 422 par.1.të KPRK-së,me propozim që të caktohet shqyrtimi gjyqësorë, të administrohen provat dhe pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësorë, të pandehurit të shpallen fajtorë, të dënohen sipas ligjit dhe të obligohen në paguarjen e shpenzimeve të procedurës penale si dhe të pandehurit V.T.të i shqiptohet edhe dënimi plotësues , ndalimi i ushtrimit të profesionit në administratën publike ose në shërbim publik, si dhe të konfiskohen një kartëmonedhë në shumë prej 1 x 50 €, me nr. serik ....., një kartëmonedhë në shumë prej 1x 10 euro, me numër serik ..... si dhe një kartëmonedhë në shumë prej 1 x10 € me numër serik .....

Në shqyrtinin gjyqësorë të mbajtur me dt.05.05.2023, palët në procedurë, në fjalën përfundimtare, kishin deklaruar si në vijim:

Prokurori i shtetit Ersan Qavolli, në fjalën përfundimtare ka deklaruar se unë fjalën përfundimtare e kam përgatitur në formë të shkruar dhe të njëjtën do të iu dorëzoj palëve dhe trupit gjykues, kërkoi që e njëjta të jetë pjesë përbërëse e këtij procesverbale dhe të njëjtën do ta elaboroi gojarisht dhe njëherit propozon që të pandehurit të shpallen fajtor, të dënohen sipas ligjit dhe të obligohen në paguarjen e shpenzimeve të procedurës penale si dhe njëherit të pandehurit V. të i shqiptohet edhe dënimi plotësues , ndalimi i ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose të shërbimit publik nga neni 59 par.2. nënpa.2.3. lidhur me nenin 62 par.3. të KPRK-së, Gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor faktet të cilat kishim për qëllim t’i vërtetojmë janë si më poshtë:a ishte në cilësinë e personit zyrtar i akuzuari V.T.ditën kritike,a i ka kryer detyrat e tij zyrtare ditën kritike, si pasoj e veprimeve të tij, a është shkaktuar ndonjë dëm,a ka përfituar ai,a ka paguar ryshfet i akuzuari Sh.G. të akuzuarit V.. Këtyre pyetjeve, pas administrimit të provave të cilat janë përshkruar në detaje më poshtë, u janë dhënë përgjigjet nga faktet e vërtetuara si në vijim:I akuzuari nga viti 2003 deri me datën 08.03.2020 ka qenë oficer doganor.I akuzuari ditën kritike ishte në punë në pikën doganore në K.dhe kishte cilësinë e personit zyrtar.Njëra ndër detyrat e shumta si zyrtar doganor, është edhe kontrollimi i veturave dhe rimorkiove të mbuluara në të cilat nuk shihet hapësira e brendshme. Ditën kritike në pikën doganore ku ishte i akuzuari, me veturën e tij dhe një rimorkio të mbuluar vie i akuzuari Sh.G..Në atë rimorkio kishte mallra të ndryshme me vlerë prej 755 €. I akuzuari V.T.nuk e kontrollon fare rimorkion për të shikuar se çka kishte brenda por i kërkon Sh.G. që të shkojnë në zyre te ai dhe të lë diçka.Sh.G., kthehet në veturë, i merr 50€, i fut në pasaportë, kthehet në zyrë tek i akuzuari V. dhe i’a jep pasaportën me 50€.I akuzuari i merr 50€, i kthen pasaportën të akuzuarit Sh., i cili shkon në veturë dhe nisat në drejtim të P.. Momentin kritik i akuzuari ishte i vetëm dhe paratë janë gjetur në zyrën ku ai kishte qasje. Provat me të cilat provohet gjendja faktike e përshkruar

sikurse më lart janë: Deklarata e dëshmitares G.G.dhënë në këtë shqyrtim gjyqësor me datën 28.10.2022, Deklarata e dëshmitares V.G.dhënë në këtë shqyrtim gjyqësor me datën 27.10.2022, Deklarata e përfaqësuesit të D. B. B. dhënë në këtë shqyrtim gjyqësor me datën 15.09.2022, Deklarata e B. P. dhënë në P.Th. Pejë me datën 25.08.2021, Video – incizimi K. nga kamerat e sigurisë për datën 08.03.2020 ku shihet si në vijim: Ora: 10:07:52 – momenti kur në pikën kufitare në K. arin i pandehuri Sh. G. me automjetin dhe rimorkion e tij. Ora: 10:08:43 – vërehet i akuzuari V.T. duke dalë nga zyra e tij. Ora: 10:10:58 – 10:13:35 – paraqet pjesën kur zyrtari doganor dhe drejtuesi i automjetit afrohen së bashku tek rimorkio, bisedojnë për disa çaste dhe pastaj drejtohen për në zyrë. Në këtë periudhë kohore, vërehet se rimorkio nuk është hapur fare për të shikuar se çfarë ka brenda. Ora: 10:21:55 – 10:22:49 paraqet pjesën kur Sh.G. del nga zyra ku ishte së bashku me zyrtarin doganor, shkon tek automjeti i tij, afrohet tek dera e pasagjerit ku ishte ulur bashkëshortja e tij, hap derën dhe fut gjysmën e trupit brenda, më pastaj largohet për t’u drejtuar prapë për në zyrën e zyrtarit doganor V. T.. Që përputhet me faktin se është ky momenti kur i ka marrë të hollat e kërkuara nga i akuzuari V. dhe më pas i’a ka dhënë këtij të fundit. Ora: 10:24:25 – momenti kur Sh.G. përfundimisht del nga zyra dhe më pastaj largohet me automjetin e tij. Vendimi i D. së K. 05.3.1 dt. 09.03.2020 me të cilin është larguar përkohësisht nga puna oficeri doganor V. T. për shkak të shkeljeve nga ana e tij. Raporti përfundimtar i D. së K. 01.3.3 dt. 25.06.2021 në të cilin ndër të tjera ceken shkeljet e të akuzuarit gjatë kryerjes së detyrës zyrtare. Aktvendimi i D. së K. 03.1.7-2020-306/2 dt. 12.03.2020 në të cilin ndër të tjera ceket se vlera e mallit ka qenë 755€ ndërsa shmangia dhe dëmi i shkaktuar nga Sh.G. është 225€. Dokumenti unik doganor dt. 13.03.2020 në të cilin ceket çmimi për njësi të mallit 755€ me vlerën të shmangies 224.99€. Dëftesa e datës 12.03.2020 në të cilin ceket shitja e mallrave në vlerë prej 755€. Dëftesa e datës 12.03.2020 në të cilin ceket dëmi i shkaktuar në shumën prej 225€. Kartëmonedhat e sekuestruara në shumën prej 70€ ditën kritike në vendin ku kishte qasje, ditën kritike vetëm i akuzuari. Raporti i policit S. I. dt. 08.03.2020 në të cilin ceket fakti se është raportuar rasti se i akuzuari kishte marrë ryshfet 50€. Raporti i oficerit B. M. K.I. 9742 dt. 08.03.2020 në të cilin ndër të tjera ceket se si është pranuar informata se i akuzuari V. i kishte marrë ryshfet 50€ e më pas përshkruhen edhe veprimet e ndërmarra. Raporti për lëshimin e urdhrit retroaktiv i Policisë së Kosovës dt. 08.03.2022 në të cilin ndër të tjera ceket se “në zyrën ku qëndrojnë doganierët në pikë kufitare në K., të fshehura në një dyshek janë gjetur dhe konfiskuar 70€”. Procesverbali i kontrollit të vendbanimeve, lokaleve dhe pronës dt. 08.03.2020 në të cilin ceket se tek zyra e doganës pika kufitare K. janë sekuestruar monedha prej 50€ dhe dy tjera nga 10€. Procesverbali i sendeve të konfiskuara (pjesa e ....). Dokumentet e të pandehurit Sh. G.. Hyrje daljet e të pandehurit Sh. të cilat konfirmojnë faktin se ai ditën kritike ka hyrë në Kosovë. Foto – albumi i vendit të ngjarjes në të cilin shihet vendi i kryerjes së veprës penale, vendi ku janë gjetur të fshehura paratë, si dhe shihen gjërat të cilat ishin në rimorkion e të akuzuarit Sh.. Shkrimi i të pandehurit Sh. G. dt. 08.03.2020 në të cilat mirë vërehet se nuk është përmendur fare vlera e mallit. Deklarata e të akuzuarit Sh.G. dhënë në këtë shqyrtim gjyqësor me datën 07.04.2023 i cili ndër të tjera e pranon fajësinë për veprën penale e cila i vihet në bar dhe shton se si kishte ardhur me veturën e tij dhe një rimorkio të mbuluar me ceradë nga Gj. në të cilin kishte gjëra të ndryshme. Po ashtu i njëjti tregon se si i akuzuari i kishte kërkuar para, më pas i ka paguar shumën prej 50€ për çka i akuzuari V. nuk i ka kontrolluar rimorkion por e ka lejuar të kalojë. Referuar të lartcekurave, pas administrimit të të gjitha këtyre provave dhe

analizimit të tyre një nga një, është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se në veprimet e tyre qëndrojnë elementet e veprave penale të përshkruara si më lart.

Mbrojtësi i të akuzuarit V., av. Kujtim Kërveshi në fjalën përfundimtare ka deklaruar se fjalën përfundimtare e kam të përgatitur në formë të shkruar dhe një kopje ia dorëzoi trupit gjykues dhe palëve në procedurë, të njëjtën do ta elaboroi gojarisht dhe i propozoi gjykatës që e njëjta të konsiderohet si pjesë përbërëse e procesverbalit, andaj i propozoi gjykatës që pas administrimit të të gjitha provave që i kam cekur në fjalën përfundimtare të shkruar, ta lironi nga kjo aktakuzë të mbrojturim tim për shkak se nuk ka as prova të drejtpërdrejta e as rrethanore e as nuk ka prova të drejtpërdrejta që vërtetojnë dashjen direkte të keqpërdorimit të detyrës zyrtare, ndërsa për veprën penale, marrja e ryshfetit nuk ka asnjë provë. Më tutje mbrojtja thekson se siç ka deklaruar i mbrojturi im V., rimorkio është hapur mjaftueshëm për ta shikuar se çfarë sende ka brenda, nga kamerat e siguruara gjatë hetimit, një pjesë e konsiderueshme e kohës, nga dy kamerat shihet V.T. dhe Sh.G. prapa rimorkios, por veprimet e tyre nuk shihen në kamerë. Më tutje në fjalë përfundimtare të shkruar, mbrojtësi ka deklaruar se neni 22 i KPRK-së, parasheh, dijenia, dashja, pakujdesia ose qëllimi i kërkuar si element i veprës penale mund të nxirret nga rrethanat faktike, kurse neni 21 i KPRK-së parasheh, personi vepron me dashje direkte kur është i vetëdijshëm për veprën e vet dhe e dëshiron kryerjen e saj. I pandehuri V. ka ndërmarrë veprimet e tij karshi autorizimeve ligjore duke përpiluar këtu edhe dokumentin e lirit nga detyrimet doganore ashtu siç parasheh ligji e përpiluar me dorë nga i akuzuari Sh.G. dhe e nënshkruar nga ai dhe e vulosur me vule të doganës, arsyeja pse është përpiluar në formë të tillë, argumentohet dhe vërtetohet se nga kushtet e këqija të punës dhe në mungesë të materialit për formular, është dashur që të veprohet në këtë mënyrë. Më tutje në fjalën e shkruar përfundimtare, mbrojtësi deklaroi se me asnjë provë nuk është vërtetuar se i mbrojturi i tij të ketë marrë shumën prej 50 euro, ashtu siç i vihet në barë sipas aktakuzës, dhe as nuk është vërtetuar se i njëjti nuk ka vepruar në pajtim me detyrat e tij zyrtare ashtu që i bashkakuuari tjetër të mos i nënshtrohet kontrollit doganorë. Mbrojtja konsideron se deklaratave të dëshmitareve V. dhe G. G., nuk duhet falur besimin ngase të njëjtat gjatë fazave të ndryshme të procedurës, kanë ndryshuar deklarin e tyre. Njëherit fjala përfundimtare e shkruar në tërësi është pjesë përbërëse e shkresave të lëndës.

I pandehuri V.T. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se në tërësi pajtohem me fjalën përfundimtare të mbrojtësit tim dhe shtoi se personit në fjale kur as nuk i kam kërkuar edhe kur as nuk i kam marrë para, malli që e ka bart me vete kanë qenë sende personale të përdorura dhe nuk ka pasur mall komercial por të vjetër, e lus gjykatë që të më liroi nga kjo aktakuzë e cila nuk është e bazuar në asnjë provë, ngase e njëjta më ka shkaktuar ngarkesë personale, familjare dhe financiare.

Mbrojtësja e të pandehurit Sh.G. av. Shqipdon Maraj Ferizaj, në fjalën përfundimtare ka deklaruar se meqenëse i mbrojturi im që nga fillimi i kësaj procedure e deri me tani e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet edhe pasi që kjo gjen mbështetje në provat që gjenden në shkresat e lëndës e që paraprakisht janë bërë të njohura pasojat dhe privilegjet e pranimit të fajësisë, i njëjti në mënyrë vullnetare ka pranuar fajësinë, andaj ne sot në fjalën përfundimtare i propozojmë gjykatë që me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin, ndaj të mbrojturit tim të merr parasysh si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë, bashkëpunimin e tij me organet e hetuesisë, sjelljen e tij të mirë, gjendjen e tij ekonomike e që është mbajtes i familjes dhe ndaj të mbrojturit tim të shqiptoi një dënim sa më të butë.

I pandehuri Sh. G. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se në tërësi pajtohet me fjalën përfundimtare të mbrojtëses së tij dhe tjetër nuk ka se çka të shtoi .

Përfaqësuesi i D. të K. B. B., edhe pse i ftuar në mënyrë të rregullt në shqyrtim gjyqësorë, nuk ka ardhur edhe përkundër faktit se ftesën e ka pranuar në mënyrë të rregullt.

Gjykata, në këtë çështje juridiko penale, i ka administruar të gjitha provat që gjenden në shkresat e lëndës, në lidhshmëri logjike dhe faktike me njëra tjetrën dhe atë si në vijim: Raporti Policit S. I. #...., i përpiluar nën nr. të rastit: ....-...-..., dt. 08.03.2020; Raporti i oficerit B. M. #...., i përpiluar nën nr. të rastit: ....-...-..., dt. 08.03.2020; Deklarata e të dyshuarit V. T., e dhënë pranë NJHKEK - Pejë, dt. 08.03.2020, Deklarata e të dyshuarit Sh.G., e dhënë pranë NJHKEK - Pejë, dt. 09.03.2020; Deklarata e të dyshuarit Sh.G., e dhënë pranë NJHKEK – P., dt. 08.03.2020, fillimisht në cilësinë e dëshmitarit; Deklarata e dëshmitares V. G., e dhënë pranë Stacionit Policor – Njësitit të Hetimeve – P., me dt. 08.03.2020; Deklarata e dëshmitares G. G., e dhënë pranë Stacionit Policor – Njësitit të Hetimeve – P., me dt. 08.03.2020; Raporti i policisë nën nr. të rastit: ....-...-..., dt. 08.03.2020, lidhur me kontrollin e zbatuar sipas urdhrit verbal të gjyqtarit të procedurës paraprake; Procesverbal mbi zbatimin e kontrollit në zyrën e personelit doganor në pikën kufitare në K., i përpiluar nën nr. të rastit: ....-...-..., dt. 08.03.2020, Dokumentacioni i automjetit dhe rimorkios, pronë e të pandehurit Sh.G.; Fotoalbumi nga vendi i ngjarjes dhe fotografi të gjësendeve të gjetura në rimorkio, pronë e të pandehurit Sh.G.; Deklarata e shënuar me dorë nga Sh.G., e cila mban dt. 08.03.2020 dhe vulën “D. e K.”; Një (1) CD, videoincizim nga vendi i ngjarjes; Aktvendimi i D. së K. - Sektori për Kundërvajtje – P., nën nr. ....-...-.../., dt. 12.03.2020 dhe faturat përcjellëse; Raporti i ekspertimit nën nr. ref: .../....-...-.../....-..., dt. 19.08.2020; Deklarata e të pandehurit V. T., e dhënë në Prokurori me dt. 06.10.2020; Lexohet Raporti i ekspertimit nën nr. ref: .../....-...-.../....-..., dt. 04.09.2020; Deklarata e të pandehurit Sh.G., e dhënë në Prokurori me dt. 05.07.2021; Deklarata e dëshmitares V. G., e dhënë në Prokurori me dt. 06.07.2021; Deklarata e dëshmitares G. G., e dhënë në Prokurori me dt. 06.07.2021; Deklarata e përfaqësuesit të palës së dëmtuar D. së K., B. P., e dhënë në Prokurori me dt. 25.08.2021; Raporti përfundimtar i D. së K. – Sektori për Standarde Profesionale – P., nën nr. ..../., dt. 25.06.2021; Vendimi i doganës i dt. 09.03.2020, D.- i dt. 13.03.2020, dëftesa e datës 12.03.2020, dëftesa tjetër e dt. 12.03.2020, si dhe procesverbali i sendeve të sekuestruara, si dhe kërkesa për vlerësim të mallit e dt. 09.03.2020 si dhe mendimi për përcaktimin e vlerës nr. ... e dt. 11.03.2020. dosja D. së K..

Gjykata, gjatë shqyrtimit gjyqësorë e ka dëgjuar deklaratën e përfaqësuesit të D. të K., B.B pastaj dëshmitë e dëshmitareve V.G. dhe G.G., dëshminë e dëshmitarit Sh.S. si dhe mbrojtjen e të pandehurve V.T. dhe Sh.G..

Përfaqësuesi i D. të K. B.B në shqyrtimin gjyqësorë të dt.15.09.2022 si dhe në shqyrtimin gjyqësorë të dt.27.10.2022 ka deklaruar se e njeh të akuzuarin V.T. nga puna si zyrtarë pranë doganës. Më tutje ka deklaruar se unë kam punuar në shumë pika doganore në Kosovë e gjithashtu edhe në pikë kalimin kufitar në K., dhe i di edhe detyrat e zyrtarit të pikës , dhe njëra ndër detyrat e zyrtarit doganor është që ta ndaloj secilën maunë apo mjet transportues për mallra si dhe vetura që barten personat dhe mall, nëse një zyrtar doganor sheh se mund të jetë ngarkuar malli dhe nuk e sheh me sy hapësirën ku mund të jetë i ngarkuar automjeti ai duhet që ta hap atë hapësirë, respektivisht palës ti kërkoi që ta hap hapësirën për ta shikuar se a ka apo nuk ka mall dhe nëse ka vazhdojmë me procedurë doganore e nëse nuk ka e lejon të hyjë në territorin e Kosovës apo të dalë nga territori i Kosovës, obligimi vlen edhe për këmbësor nëse ka bagazh ose ke informata se bart para të gatshme, mall me vlerë, ari etj, etj. d.m.th, çka dyshohet se secili mall i cili mund të futen në territorin e Kosovës ku mund të lind borxhi doganor . Për rastin

konkret jam në njohuri dhe mund të them se nuk është rast i cili ka kaluar nëpër ndonjë procedurë doganore lidhur me çka këta të dy akuzohen, respektivisht akuzohen keqpërdorimi i detyrës zyrtare dhe dhënia dhe marrja e ryshfetit .Që të kaloi nëpër ndonjë procedurë doganore malli dhe të deklarohet nga pala dhe të vazhdon procesin e zhdoganimit ai proces mund të jetë në dy mënyra, mënyra e parë që janë kushte të veçanta që mund të zhdoganoi mallin në pikën kufitare në K. si në rastin konkret dhe rasti tjetër për rastin konkret do të duhej të zhdoganohet në zyrën e brendshme doganore në P. – terminali të D., dhe për shkak se nuk ka ndodhur kjo që e shpjegova, ne në doganë nuk kemi pasur procedurë doganore . Në bazë të shkresave rezulton se V.T.ka qenë përgjegjës për fillimin e procedurës doganore për përfundim varet se ish zhvilluar procedura nuk mund të paragjykoj, ndërsa i akuzuari V. nuk e ka zhvilluar atë procedurë, gjegjësisht nga sistemi i doganës nuk shohim se ka filluar ndonjë procedurë doganore. Nga shkresat e lëndës shohim se baza doganore ishte 775 €, e që kemi të bëjmë me shmangie në vlerë prej 255 € , këtë njohuri e kam nga burimet e hapura dhe të mbyllura të mbyllja i bie se kam qenë anëtar i komisionit të ankesave në trajtimin e lëndës në procedurë administrative, ndërsa e hapur është avokati Kujtim Kërveshi të cilin e kam parë rastësisht në doganë kur ka ardhur me klientin e vet dhe kam biseduar me Kujtimin të cilin e kam pyetur se për çka ka ardhur këtu dhe ai më ka treguar se e ka një rast dhe ky është burim i hapur për mu dhe më shumë nuk më kujtohet asgjë.

Dëshmitarja V.G. në dëshminë e saj të dhënë në gjykatë me dt.27.10.2022 ka deklaruar se nuk e njoh të pandehurin V. T.,e nuk e kam njohur as më parë. Me datën 08.03.2020 kemi qenë në pikën kufitare në K. , kemi ardhur nga R. e Gj. dhe kemi ardhur me veturë dhe me rimorkio, me ne ka qenë babai , nëna dhe unë, ka qenë duke e vozitur. Rimorkio ka qenë normal , ka qenë e mbuluar me ceradë . Në pikën kufitare në K. kemi ardhur në mëngjes por nuk e di saktë orën, dhe ka qenë moti me borë, ka qenë ftohtë , babai ka dal prej veturës , ka shkuar tek doganieri, kanë hyrë brenda , ka zgjatë 10 – 15 minuta dhe tani ka dal babai ka ardhur tek ne dhe ka thënë se doganieri po i kërkon 50 €, unë ia kam dhënë babait 50 € , pastaj ka shkuar babai brenda në kabinë dhe është kthyer në veturë pas një kohe të shkurtër dhe jemi nisur për P. Doganieri ceradën e rimorkios ose rimorkion nuk e ka kontrolluar.Babai ka ardhur nga kabina, gjegjësisht nga ajo zyra tani ka shkuar kah dera e nënës sime në veturë dhe pastaj unë i kam dhënë paratë , babai e qeli derën e veturës dhe na tha neve se doganieri po i kërkon 50 €, pastaj unë i kam nxjerrë paratë prej kuletës dhe ia kam dhënë babait, i kam vendos në pasaportë por nuk e di se pasaporta e kujt ka qenë, e di se i kemi dorëzuar të tretë pasaportat, babai veç ka thënë se po i kërkon doganieri mirëpo nuk e di se a ja ka japur paratë sepse nuk kam dëgjuar bisedën ngase nuk kam qenë e koncentruar në bisedën të zhvilluar në veturë. Unë paratë i kam nxjerrë prej kuletës sime sepse e kam pasur kuletën në çantë, ndërsa nuk e di, gjegjësisht nuk më kujtohet se ku e ka pasur babai im kuletën . Më tutje dëshmitarja ka deklaruar se është e sigurt se në pikën kufitare në K. është pikërisht ky personi këtu , duke aluduar në të pandehurin V. T..Më tutje dëshmitarja deklaroi se policët në restorant i kanë thënë babait a je ti ai që i ke jap paratë në doganë por e di se mandej policët kanë dalë jashtë me babain tim dhe kanë biseduar dhe pastaj bashkë me polici jemi nisur në drejtim të P., pastaj kemi shkuar në stacion policor , po sa jemi ulur aty ka ardhur policia dhe ne as që kemi ngrënë por jemi nisur në drejtim të P., ne jemi shkuar me veturë tonë ndërsa policia ka shkuar me veturë prapa neve, nuk më kujtohet se a kemi biseduar diçka në veturë deri sa kemi shkuar në stacionin policor .

Dëshmitarja G.G. në dëshminë e saj të dhënë në gjykatë me dt.28.10.2022 ka deklaruar se të akuzuarin V.T.nuk e kam parë kurë, por herën e parë e kam parë në doganë. Me datën 08.03.2020,kemi qenë në pikën Kufitare në K. ,jemi nisur nga Gj. bashkëshorti me vajzën V. dhe unë, me automjetin tonë M. ,në veturë ka qenë e ngjitur një rimorkio , ajo rimorkio ka qenë e mbuluar me ceradë . Meqenëse unë kam qenë në punë dhe rimorkion e ka përgatitur bashkëshorti im, unë nuk e di se çka ka pasur në rimorkio por sipas asaj që më ka treguar



bashkëshorti aty ka pas sendet të vjetra, disa kosa të barit , shara të motorit ndërsa për tjera nuk e kam pyetur sepse kam qenë e lodhur prej punës .Nuk e di saktë sepse ka kaluar një kohë, por ka qenë diku përafërsisht 09:30 – 10:00, kur kemi arritur në R., ka pasur shumë borë , shi , mjegull , ndërsa kur kemi mbëri në K., aty ka qenë pak mjegull por nuk ka pasur të reshura. Në pikën kufitare në K. kemi mbëri dhe e kemi ndalur automjetin, doganieri ka qenë përjashta, bashkëshorti e ka marrtë dokumentacionin dhe ka dal jashtë prej veturës dhe ka fol me doganierin dhe është hyrë brenda në zyrën e doganierit së bashku me doganierin. Pas dhjetë minutave bashkëshorti ka ardhur përsëri tek automjeti dhe ka thënë se doganieri po i kërkon 50 € , unë i mora prej kuletës së Sh. 50 € i cili e kishte kuletën përpara dhe ia dhashë vajzës V. ndërsa edhe ajo më tha se ka të holla , unë vetëm ia kam japur vajzës të hollat dhe nuk e kam par se çka ka bërë mbrapa ndërsa ne kemi qenë të lodhur dhe të lagur sepse kemi udhëtuar 40 orë pa livrit ,vajza V. ka qenë prapa në veturë dhe aty në veturë prapa kanë qenë edhe çantat ndërsa nuk më kujtohet se a i kemi japur pasaportat. Ato të holla ia kemi dhënë ngase i ka kërkuar doganieri dhe pas pak kohe ka dal bashkëshorti me një copë letër të bardhë dhe ne kemi menduar se këto para janë që janë paguar për atë mall , ajo copë e letrës e kishte pasur vulën po shuma e parave nuk ka qenë askund e shkruar .Kur e kam parë letrën, kanë qenë të shkruara disa gjëra që ia ka marr mendja Sh. se janë në rimorkio dhe unë i thash Sh. se pse nuk shkruan shuma e parave prej 50 € dhe i thash se ma mirë kishte qenë me i kontrolluar se mos me i qit 50 €, të shkruara në letër ka qenë vula ndërsa parat nuk kanë qenë të shkruara. Prej doganës kemi shkuar tel lokali Sh. e B. dhe aty jemi ulur dhe i kam thënë shefit të lokalit a bënë që të na vendos diku ku është më nxehtë dhe na ka ulur në një vend ku ka qenë më nxehtë , kemi porositur ushqim diçka çka ka qenë e mundshme më shpejtë dhe deri sa ka ardhur ushqimi ne të tre, unë, Sh. dhe V. kemi biseduar se pse nuk është shkruar kjo shumë e parave në letër , ende pa arritur ushqimi , kanë ardhur dy policë dhe aty na kanë thënë se a jeni ju ata që jeni ardhur qetash prej dogane dhe na kanë thënë se a i keni dhënë ju 50 € dhe ne i kemi thënë po , kanë ardhur policia kemi dal përjashta dhe kemi shkuar së bashku me policinë në stacion policor në P..

Dëshmitari Sh.S.në dëshminë e tij të dhënë në gjykatë me dt.06.02.2023 ka deklaruar se V. T. e njoh nga shkolla komerciale sepse në vitin 1999 kemi qenë bashkë, ai punon oficer i lartë doganor, në pikë kalimin kufitar në K.. V. ka punuar në të njëjtën pozitë sikurse unë . Me datën 08.03.2020 kam qenë në punë , kolegu im V. ka pranuar punën në ora 08:00 në mëngjes , unë atë ditë nuk kam qenë në punë deri në ora 10:30 për arsye shëndetësore dhe nuk kam qenë në punë në momentin kur V. e ka pranuar detyrën, kam ardhur në ora 10:30 dhe kur kam arritur në pikën doganore, në pikë ka qenë vetëm V. prej zyrtarëve doganor. Meqë përshkrimi i detyrave të punës për një zyrtarë doganor është më i gjatë unë do të flasë vetëm për rastin konkret , në rastin konkret obligimi i zyrtarit dhe përshkrimi i vendit të punës është që pala pasi të regjistrohet në polici, pastaj nga zyrtari doganor bëhet shiqimi i mallit numërimi i tij , vlerësimi i tij, dhe kur vërtetohet se është i natyrës komerciale bëhet procesimi i deklaratës apo T1, mirëpo në rastin konkret meqë malli nuk ka qenë i natyrës komerciale , vendoset në formularin e përshkruar është procedura e lirimit sipas KDAK-së ( kodi doganor i akcizave ) , meqë z. G në sistemin e aplikimit të të dhënave në sistem nuk ka qenë asnjëherë i procesuar dhe i adresuar si palë komerciale , është vazhduar me procedurën e lirimit. Sistemin që e posedon dogana janë dy aplikacione ku vërtetohet që nuk ka qenë palë komerciale në 1 . Fillimisht kërkohet S. ( sistem i të dhënave ) përmes të cilit dëshmohet se shteti i fundit në këtë rast M. i z. nëse malli është i natyrës komerciale e lëshon deklaratën eksportuese dhe nën 2. Sistemi tjetër ku bëhet procesimi i deklaratave dhe T. –shave i quajtur ... .... dhe duke marrë faktin parasysish se z. G. siç e potencova më herët nuk ka figuruar dhe nuk ka poseduar nga sistemi S.. deklaratë eksportuese e as nga sistemi i Malit të Zi, po ashtu nuk ka figuruar as në sistemin A. C. nuk ka figuruar asnjëherë si palë komerciale në vitet paraprake . Në rast kur makina ka rimorkio të mbuluar bëhet hapja e

ceradës në rimorkio, hapja e bagazhit dhe numërimi i mallit, dhe kam njohuri se këtu i akuzuari V. i ka ndërmarrë këto hapa, afërsisht e di se çka ka pasur në atë rimorkio dhe unë si zyrtarë, gjegjësisht në rastin konkret për V. i njëjti nuk ka pasur për obligim që ta ngarkoi palën me taksa doganore, edhe sikur të kisha qenë unë të njëjtën ditë në vend të V. it e kisha bërë të njëjtin veprim për lirim të mallit për faktin se z. G. në veturën e tij ka qenë vetë i treti edhe për këtë fakt edhe me ligjet në fuqi dhe rregulloret e doganës çdo palë e ka të drejtën e lirimit deri në 175 euro, dhe meqë kanë qenë tre persona, vlera për lirim e obligimeve doganore ( baza doganore ) shkon në 525 Euro .Në bazë të konsultimit që e kam pasur me V. në punë kur kam shkuar, mendimi i tij ka qenë rreth 700 euro dhe nuk mendoi se ka gabuar. Aktvendimi i cili është përpiluar nga dogana sipas rregullit e përcakton sektori i pranimit të mallit me rastin e paraqitjes për zhdoganim, mirëpo edhe siç shihet vlerësimin e mallit të cilin e ka bërë kolegu kur potencova më herët në vlerë prej 700 euro, është shumë i përafërt me vlerën e sektorit të pranimit të mallit, me këtë rast gjatë bashkë bisedimit me kolegun deklaroi me përgjegjëses të plotë morale se me të arritur në detyrë kolegu V. më ka treguar dhe e ka faktuar se vlerësimin e mallit e ka bërë në sistemin të cilin e ka dogana ku është referuar në dosjen e vlerës. Sektori i pranimit i ka 6 metoda të vlerësimit ku me rastin e paraqitjes së mallit mund të i referohesh njëerës nga metodat që ti mendon se është e arsyeshme me vlerën reale, në rastin konkret është metoda e vlerësimit I (një) d.m.th. përmes paraqitjes së deklaratës së palës.

I pandehuri V.T.në mbrojtjen e tij të dhënë në gjykatë me dt.07.04.2023 ka deklaruar se unë kam hyrë në punë në doganë me 08.03.2013 dhe kam punuar deri me datën 08.03.2020, në rreth 90 % të pikave doganore të K. kam punuar, ndërsa në veri të K. kam punuar 3 vite e 6 muaj në pikat G1 dhe G31, prej viti 2015 deri në vitin 2018, ndërsa muajt nuk i di saktësisht, transporti është bërë në mënyra të ndryshme me helikopter, me kerre të blinduara, me autoblanda etj, deri sa kam punuar në veri, njerëzit nuk kanë dëshirë as të mendojnë që të punojnë aty, ndërsa unë kam punuar 3 vite e 6 muaj, dhe për këtë periudhë kohore nuk kam pasur ndonjë vërejtje ose procedurë disiplinore edhe pse fatkeqësisht në prokurorinë speciale ka shumë doganier që akuzohen për vepra të ndryshme e posaçërisht në veri. Atë ditë në K. kam qenë vetëm në ndërim, të gjitha procedurat doganore i kam zbatuar atë ditë detyrat e mia rreth kontrollit të mallit dhe mbarë vajtes së punës. Kontrollat detale të mallrave kryhen në terminal doganor, për mallëra të përdorura ose të dëmtuara doganieri ka të drejtë të vendos sipas bindjes së lirë duke siguruar informatën sipas internetit p.sh. dhe në fund vendos sipas bindjes së lirë.Pas pyetjes sime se çka keni me deklaruar për doganë i njëjti-Sh. më ka thënë se ka vetëm disa mallra, paisje personale të dëmtuara, të përdorura dhe prej të cilave mendon që prej 3 motor sharave të e bëjë një dhe që i ka për përdorim personal, për amvisëri e që nuk janë të natyrës komerciale. Unë e kam kontrolluar në sistem i cili është S.., ajo është një sistem i shtrirë në të gjitha kufijtë që i përcjell shënimet prej një shteti në shtet tjetër, p.sh. nëse ka hyrë në M. të Z. diçka me vlerë komerciale dhe ka me dal në K., neve na përcjelllet informata se në funde të ditës së punës së orarit varësisht se a punon ditën apo natën gjitha hyrjet – daljet që kanë dal nga M. i Z. të gjitha duhet të barazohet me vlerë, me kilogram, me paketime sepse për ndryshe nuk msholet raporti ditor pa kon çdo send i saktë. E kam kontrolluar edhe në një sistem tjetër të cilën i kemi aty emrat e njerëzve të cilët kanë paguar ndonjëherë doganë në pikë kalim kufitar, kjo nënkupton se nëse mundem me gjetur një emër i cili vjen çdo muaj dhe paguan çdo muaj, ai njeri është i detyruar me shkuar në terminal sepse e shohim se ai person është duke bërë biznes, në rastin në fjalë ky person nuk ka figuruar kurë, në rastin konkret pala ka bërë deklaram me shkrim dhe normal që një kopje e mbajmë ne, në fund të raportit ditor ai hynë aty dhe një kopje e merr pala me vule origjinale, ndërsa një kopje e mbajmë ne, arsyeja është që ja japim me vule origjinale se nëse e ndal dikush poshtë rrugës ta kenë si dëshmi që ky mall ka kaluar kontrollin doganor, atë ditë nuk ka pasur formular të printuar dhe për atë arsye ia kam japur një letër A4 të pastër dhe i kam thënë deklaro çfarë ke në rimorkio.Kur ka filluar të hapë rimorkion, me sy të lirë e kam par që i ka ato sende

që i ka deklaruar me gojë kur e kam pyetur herën e parë, motor sharrë, kositëse bari, burmashinë dhe vegla tjera, si e kam vërejtur se i ka ato sende i kam thënë në rregulle mbylle dhe kam kërkuar nga ai që ta bëjë një deklaratë me shkrim. As nuk i kam kërkuar para e as nuk më ka ofruar dhe as nuk kemi pasur diskutim për këtë temë, prej tij vetëm kam kërkuar deklaratën me shkrim të i cekë të gjitha sendet që i ka pasur në rimorkio. Personi ka qenë vetë i treti me një zonjë dhe një vajzë, nëse i referohem doganës dhe vlerës që të tre kanë të drejtë të i kenë nga 175 euro që i bie në rastin konkret 525 euro dhe unë kam besuar se ai mall nuk ka vlerë më shumë se 525 euro. Kjo ka qenë një rimorkio e thjeshtë dhe jo profesionale me një mbulesë – ceradë jo adekuate siç barten mallrat komerciale por ka qenë e lidhur me konop – toja dhe si e ka hapur Sh. diku 40 – 50 cantin unë e kam ulur kokën dhe kam parë se çka ka brenda dhe me gjithë ankesat e Sh. se ka udhëtuar 40 orë pa ndërprerë në borë dhe në shi, në ato kushte unë pak e kam toleruar dhe i kam thënë mbylle rimorkion. Deklarata është si formular, në pjesën e lartë është eksportuesi i mallit, më poshtë importuesi, deklaruesi i mallit dhe shpediteri nëse është biznes ndërsa për persona fizik ka dallim vetëm emri dhe mbiemri i personit fizik dhe tek deklaruesi është një kod ku cekët se dogana po ia kryen shpedicionin – deklarimin dhe rubrikat më poshtë emërtimi i mallit se çka ka, i bashkëngjitet dhe i shkruhet vlera doganore, i harmonizon këto i shkruan çka ka, ia bashka ngjet fotografitë në raste kur është malli pa faturë ose e bashkangjet deklaratën e deklaruesit nëse nuk ka faturë ndërsa kur ka faturë vetëm faturën dhe kodet e mallit. Prej se më ka ndodhur ky rast çdo herë më shkon mendja se si kanë ardhur këto para aty dhe pse bash qatë ditë kur kam qenë vetëm dhe nganjëherë mendoj se ndoshta dikujna iu kanë prishur matematikat dhe mendoj se ka qenë ndonjë kurth kundër meje ose ndonjë kolegës tjetër, por mendoj se bash atë ditë kam qenë vetëm, zyra tjetër nuk kontrollohet, aty ka pas shumë sende për të u kontrolluar, por aty kanë qenë të koncentruar bash në atë pjesë, dhe kur i kanë gjetur policia unë kam qenë në zyrë.

I pandehuri Sh.G. në mbrojtjen e tij të dhënë në gjykatë me dt.07.04.2023 ka deklaruar se me datën 08.03.2020 kam qenë në vendkalimin kufitar në K., kam ardhur nga Mali i Zi gjegjësisht prej Gj. kah M. i Z. për në K., kemi udhëtuar diku 40 orë, kam qenë unë, bashkëshortja dhe vajza, unë kam ardhur në pikë kalimin kufitar në K., së pari e kam paguar sigurimin, së dyti kam ardhur në kontroll tek policia, policia ka qenë në kabinë në anën e majtë dhe aty i kam dhënë pasaportat për të u regjistruar dhe kur i kam marr pasaportat doganieri ka dal në anën tjetër duke treguar në të pandehurin V., pastaj kam dal edhe unë kah doganieri kemi biseduar më ka pyetur se çka ke në rimorkio, i kam thënë gjësende personale të miat, atëherë më ka thënë duhet të vish në zyrë, jemi hy që të dy në zyrë, dhe më ka thënë shkruaj për afërsisht se çka ke në rimorkio, më ka japur një copë letër dhe një laps, unë i kam shënuar për afërsisht ato çka i kam një nga një dhe më ka thënë duhet të i paguash këtu, e kam pyetur sa duhet me paguar, më ka thënë 50 euro, unë jam dal prej aty, kam shkuar tek vetura ime dhe e kam hapur derën e pasagjerit dhe nuk e di cila, a shoqja apo vajza mi kanë dhënë 50 euro, i kam marrë ato 50 euro dhe kam shkuar në zyrë, ia kam qitur në tavolinë, e kam marrë letrën ku i kam shkruar sendet dhe doganieri i ka vënë një vulë dhe më ka thënë se në qoftë se të ndal ndonjë kontroll tregojta këtë letër. Rimorkio ka qenë e mbuluar dhe për rreth i ka pasur dy letva me shrafa në katër qoshe, e njëjta ka qenë e mbuluar dhe nuk ka mundur të shihet asgjë nga jashtë për pa e hapur vet. Doganieri as që ka tentuar ta hap sepse ka pasur borë mbi rimorkio e as nuk ka kërkuar prej meje që ta hapi.

Sa i përket pjesës liruese të aktgjykimit, gjegjësisht sa i përket veprës penale nga pika një e dispozitivit të aktakuzës, për të pandehurin V. T., vepra penale, keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtarë, nga neni 414 par.1 të KPRK-së, gjykata të pandehurin V. e ka liruar për këtë vepër penale, ngase, i pandehuri V.T., akuzohet edhe për vepër penale, marrja e ryshfetit, nga neni 421 par.1 të KPRK-së, nga pika dy e dispozitivit të aktakuzës, andaj, në rastin konkret, kur

kryesi i veprës penale , marrja e ryshfetit, ka ndërmar edhe veprime të tilla që përbëjnë keqpërdorim të detyrës zyrtare dhe autorizimeve, ka konsumuar veprën penale të marrjes së ryshfetit në bashkim me veprën penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare , pra , në rastin konkret i pandehuri V. T., në cilësinë e doganierit, ka marë ryshfet nga i pandehuri Sh.G., për të mundësuar që të mos e paguaj doganën për mallin e importuar, me këtë veprim ai ka marrë ryshfet për vete,ndërsa duke keqpërdorur detyrën zyrtare dhe autorizimin,i ka siguruar të pandehurit tjetër përfitim material, me qka ka konsumuar dy vepra penale.

Sa i përket pjesës dënuese të këtij aktgjykimi, gjykata e ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

I pandehuri V. T., në pikën dy të dispozitivit të aktakuzës, akuzohet se me dt. 08.03.2020, rreth orës 10:20, në zyrën e personelit doganor në pikën kufitare në K. (në hyrje) K. P., në cilësinë e personit zyrtar, në mënyrë të drejtpërdrejtë pranon përfitim pasuror për vete ,me qëllim që të mos veprojë në pajtim me detyrën e tij zyrtare , në atë mënyrë që ,në kohën dhe vendin e lartcekur , shkon i pandehuri Shefqet Gosturanaj ,i cili po e drejtonte automjetin “Mercedes” me targa ..... dhe rimorkion me targa ....., ku edhe kishte të ngarkuar gjësendet të ndryshme ( motor shara , Kositëse bari, biçikleta etj), ashtu që i pandehuri, në cilësinë e zyrtarit doganor, në zyrën e tij, kërkon e pastaj merr nga drejtuesi i automjetit një bankënotë prej 50 €, me nr. serik ....., me qëllim që malli që posedonte ky i fundit të mos i nënshtrohej procedurave të kontrollit doganor, me çka ka kryer veprën penale, marrja e ryshfetit , nga neni 421 par.1. të KPRK-së.

I pandehuri Sh.G. akuzohet se me dt. 08.03.2020, rreth orës 10:20, në zyrën e personelit doganor në pikën kufitare në K. ( në hyrje), K. P., në mënyrë të drejtë për drejtë i jep përfitim pasuror personit zyrtar, me qëllim që ky i fundit të mos veprojë në pajtim me detyrën e tij zyrtare , në atë mënyrë që me të arritur në vendin e lartcekur , me automjetin “M.” me targa ....., dhe rimorkion me targa ....., të cilin po e drejtonte , e në të cilin kishte të ngarkuara gjësende të ndryshme , i njëjti me qëllim të mosnënshtimit të procedurave të kontrollit doganor, i ofron zyrtarit doganor V.T., një bankënotë prej 50 €, me nr. Serik ....., të cilin me kërkesën e tij e vendos në pasaportë të vajza e tij V. e cila gjendej në automjet , e më pas ia jep atë të pandehurit V. në zyrën e tij, me çka ka kryer vepër penale “ dhënia e ryshfetit “ nga neni 422 par.1.të KPRK-së.

Gjykata, gjendjen faktike,për kryerjen e veprës penale të marrjes së ryshfetit për të pandehurin V. T.,si dhe për vepër penale, dhënia e ryshfetit për të pandehurin Sh.G., e vërtetoi nga administrimi i provave si në vijim:

Nga deklaratat e përfaqësuesit të autorizuar B.B në cilësinë e palës së dëmtuar, i cili ka deklaruar se njëra ndër detyrat e zyrtarit doganor është që ta ndaloj secilën maunë apo mjet transportues për mallra si dhe vetura që bartin personat dhe mall, nëse një zyrtar doganor sheh se mund të jetë ngarkuar malli dhe nuk e sheh me sy hapësirën ku mund të jetë i ngarkuar automjeti ai duhet që ta hap atë hapësirë, respektivisht palës ti kërkoj që ta hap hapësirën për ta shikuar se a ka apo nuk ka mall, dhe nëse ka vazhdojmë me procedurë doganore, e nëse nuk ka e lejon të hyjë në territorin e Kosovës apo të dalë nga territori i Kosovës, obligim vlen edhe për këmbësorë nëse ka bagazh ose ke informata se bart para të gatshme, mall me vlerë, ari etj, etj, e që në rastin konkret i pandehuri V. nuk i ka zhvilluar këto procedura. Deklarimit të përfaqësuesit të D.e të K., gjykata ia fali besimin e plotë.

Nga dëshmia e dëshmitares V.G., e cila gjykatës ia ka shpjeguar në mënyrë të qartë se ditën kritike, i pandehuri V. ka qenë në ndërim, pastaj babai i saj ka hyrë në kabinën e doganierit, ka dalë nga kabina, është ofruar kah dritarja e pasagjerit në veturë, ku ka qenë ulur nëna e V. , G.,

gjegjësisht bashkëshortja e Sh., babai iu ka thënë se doganieri po i kërkon 50 Euro, ia ka japur paratë dhe i njëjti ka hyrë në kabinë dhe ia ka japur doganierit paratë dhe doganieri nuk e ka kontrolluar fare mallin dhe pastaj janë nisur në drejtim të P. Gjykata, dëshmisë së kësaj dëshmitare ia ka falur besimin e plotë, ngase e njëjta edhe në polici e edhe në prokurori kishte deklaruar njejtë, dhe me këtë deklaratë, gjykata e ka vërtetuar faktin se Sh.G. i kishte dhënë 50 Euro doganierit në emët të ryshfetit gjë që e kishte pranuar edhe vet, gjersa doganieri V.T. nuk e kishte doganuar fare mallin.

Nga dëshmia e dëshmitares G.G. e cila gjykatës ia ka shpjeguar në mënyrë të qartë se ditën kritike kur kanë mbëri në vendkalimin kufitar në K., Sh. ka dalë nga vetuar ka shkuar në kabinën e doganierit, është kthyer nga kabina dhe i ka kërkuar 50 Euro, ngase po i kërkon doganieri, i ka nxjerrë 50 Euro nga kuleta e Sh. të cilën e kishte përpara në veturë dhe ia ka japur vajzës së tyre V. e cila i ka thënë se ka para, pastaj ia kanë japur Sh. dhe i njëjti ia ka dërguar doganierit në kabinë, ka dalë Sh. nga kabina me një letër në dorë ku kanë qenë të shkruara disa sende të cilat ia ka mar mendja ti shënoi, por në atë letër nuk ka qenë e shënuar askund shuma e të hollave prej 50 Euro, por ka qenë vetëm një vule e doganës, pastaj janë nisur në drejtim të P. dhe në restorantin Sh. e B. janë ndalur të drekojnë, dhe ka ardhur policia, i ka pyetur, a jeni ju ata që i keni japur 50 Euro në doganë dhe i kanë shoqëruar në Stacion policorë. Gjykata, dëshmisë së kësaj dëshmitare ia ka falur besimin e plotë, ngase e njëjta edhe në polici e edhe në prokurori kishte deklaruar njejtë, dhe me këtë deklaratë, gjykata e ka vërtetuar faktin se Sh.G. i kishte dhënë 50 Euro doganierit në emët të ryshfetit, gjersa doganieri V.T. nuk e kishte doganuar fare mallin.

Dëshmitari Sh.S. në dëshminë e tij e ka përshkruar mënyrën e veprimeve të cilat duhet ndërmarë një doganier gjatë doganimit të ndonjë malli, gjë që gjykata ia fali besimin në këtë pjesë të dëshmisë, mirëpo nuk ia fali besimin deklaratës së tij se në rastin konkret do të vepronte edhe ai sikurse V. T., ngase në rastin konkret dëshmitari Sh., në dëshminë e tij e shpjegoj se si duhet vepruar me rastin e doganimit të ndonjë malli, qoft komercial apo jokomercial, e që në rastin konkret kolegu i tij V. i ka anashkalu këto procedura, por gjykata në këtë pjesë të dëshmisë nuk i besoj këtij dëshmitari ngase me këtë deklaram i njejtë kishte për qëllim që ta bindë gjykatën se në veprimet e të pandehurit V. nuk ka elemente të ndonjë veprë penale, ngase i njejtë ka vepruar drejtë, mirëpo në kabinën e doganierëve, me rastin e bastisjes janë gjetur apoenat prej 2x10 euro dhe 1x 50 euro, të cilat janë gjetur nën dyshek në kabinën e doganierëve.

I pandehuri V.T., në mbrojtjen e tij në gjykatë, ka deklaruar se e ka hapur rimorkion dhe e kishte shiquar mallin, mirëpo në polici, në deklaratën e dhënë me dt.08.03.2020, në prezencën e mbrojtësit kishte deklaruar se nuk e ka kontrolluar rimorkion, pastaj në deklaratën e dhënë në prokurori me dt.06.10.2020, gjithashtu në prezencën e mbrojtësit të tij, kishte deklaruar se nuk e kishte kontrolluar rimorkion, gjersa në mbrojtjen e tij të dhënë në gjykatë, i njëjti ka deklaruar se e ka kontrolluar, gjegjësisht e ka shiquar mallin në rimorkio me sy të lirë, gjë që gjykata mbrojtjes së tij nuk ia fali besimin, ngase tani në shqyrtim gjyqësorë e kishte ndëruar deklaratën, e krejt kjo me qëllim të shmangies nga përgjegjësia penale, me preteks se kishte vepruar konform procedurave doganore ditën kritike.

Gjykata i besoj në tërësi mbrojtjes së të pandehurit Sh.G., sepse i njejtë në të gjitha fazat e procedurës penale, kishte pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohej, e poashtu edhe në gjykatë, mirëpo, gjykata nuk ia pranoj fajësinë, por të njëjtit gatishmërinë për pranimin e fajësisë ia kishte marë si rrethanë lehtësuese me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin.

Nga shikimi i CD të kamerave nga pikë kalimi kufitar, shihet qartë se cerada e rimorkios nuk ishte e hapur, e gjithashtu edhe nga foto dokumentacioni, dhe gjykata kësaj prove ia fali besimin,

Nga foto dokumentacioni me rastin e bastisjes së zyrës së doganës , shihet qartë se nën dyshek të krevatit që gjendet në këtë zyre të doganës, janë gjetur dy apoena nga 10 euro si dhe një apoen prej 50 euro, dhe parashtrohet pyetja se përse këto para kanë qenë të vendosura në atë vend edhe përkundër faktit se i pandehuri V. ka deklaruar në gjykatë se atë zyre e frekuentojnë edhe persona të tjerë, mirëpo në polici dhe në prokurori kishte deklaruar se ditën kritike kur ka ndodhur ngjarja, ai ka qenë vetëm në kabinë sepse kolegu i tij i ndërrimit, në ato momente nuk ishte në vendin e punës.

Sa i përket raportit të ekspertimit të ADN profileve të punuar me dt.19.08.2020, edhe përkundër faktit se për të pandehurin V. nuk është identifikuar ADN me origjinë njerëzore, ndërsa për të pandehurin Sh., është konstatuar se nuk është fituar ndonjë profil i ADN-së, për shkak të sasisë së pamjaftueshme të ADN-së, nuk është kontestuese se ditën kritike , të hollat , gjegjësisht apoena prej 1x50 euro, është gjetur në zyrën e doganierëve me rastin e bastisjes edhe përkundër faktit se i pandehuri V. deklaron se nuk e din se të kujt janë ato të holla, por i njëjti ditën kritike ka qenë vetëm në zyre.

Andaj , nga të gjitha të lartë cekurat , pas administrimit të provave dhe në lidhshmëri logjike dhe faktike me njëra tjetrën, gjykata erdhi në përfundim se në veprimet e të pandehurit V.T.ekzistojnë të gjitha elementet e veprës penale, marrja e ryshfetit, nga neni 421 par.1. të KPRK-së, ndërsa për të pandehurin Sh.G., për vepër penale, dhënia e ryshfetit , nga neni 422 par.1. të KPRK-së, dhe njëherit ka kaluar në marrjen e vendimit mbi dënimin.

Gjykata, me rastin e marrjes së vendimin mbi dënimin, për të pandehurin V.T.dhe të pandehurin Sh.G., i vlerësoi të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, për të pandehurin V., gjykata si rrethanë lehtësuese mori për bazë faktin se i njëjti gjer më tani nuk ka qenë i dënuar për ndonjë vepër penale, sjelljen e mirë në gjykatë, ndërsa si rrethanë rënduese mori për bazë faktin se i pandehuri është zyrtarë doganorë dhe me veprimet e tij e vënë në pozitë të keqe imazhin e doganave të Kosovës të cilat janë kontribueset më të mëdhaja të mjeteve në buxhet të Kosovës , ndërsa ,gjykata për të pandehuri Sh. si rrethana lehtësuese mori për bazë, gatishmërinë për pranimin e fajësisë në të gjitha fazat e procedurës penale, gatishmërinë e tij për të bashkëpunuar me organet e ndjekjes në zbardhjen e rastit, sjelljen e mirë në gjykatë, ndërsa, gjykata rrethana rënduese nuk gjeti, andaj edhe të pandehurve secilit veq e veq, iu shqiptoi dënimin sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e bindur thellësisht se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i sanksionit penal, dhe të pandehurit do të parandalohen që në të ardhmen të kryejn ndonjë vepër tjetër penale.

Konform nenit 59 par.1. dhe 2 nën par. 2.3, të KPRK-së, të pandehurit V.T.iu është shqiptohet dënimi plotësues, ndalimi i ushtrimit të profesionit në administratën publike ose në shërbim publik, në kohëzgjatje prej 1 (një viti ) nga vuajtja e dënimit me burg.

Gjykata,një kartëmonedhë në shumë prej 1 x 50 €, me nr . serik ....., një kartëmonedhë në shumë prej 1x 10 euro me numër serik ..... si dhe një kartëmonedhë në shumë prej 1 x10 € me numër serik ....., **Konfiskohen** dhe të njëjtat pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit urdhërohet që të alokohen në mjetet buxhetore të Republikës së Kosovës.

Për pjesën liruese të aktgjykimit, për të pandehurin V. T.,konform nenit 453 par.1 të KPRK-së , shpenzimet e procedurës penale iu janë ngarkuar mjeteve buxhetore të gjykatës.

Për pjesën dënuese të aktgjykimit, të pandehurit V.T.dhe Sh.G., konform nenit 452 par.1 të KPPRK-së, janë obliguar në paguarjen e shpenimeve të procedurës penale dhe paushallit gjyqësorë, ndërsa konform ligjit nr.05/L-036 , në paguarjen e taksës për kompensimin e viktimave të krimit.

Konform nenit 462 par.1 dhe 2 të KPPRK-së, për realizimin e kërkesës pasuroro juridike , pala e dëmtuar është udhëzuar në kontest të rregullt juridiko civil.

Andaj, nga sa u tha më lartë, është vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË- Departamenti për Krime të rënda,PKR.nr.147/21, datë 25.05.2023**

**Sekretarja juridike**  
Lulavere Mala

**Kryetari i trupit gjykues**  
Sami Sharaxhiu

### **KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa, në afat prej 30 (tridhjetë)ditëve nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, e përmes kësaj gjykate.